

L I G J
Nr.7796, datë 17.2.1994

LIGJI MINERAR I SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. 8093, datë 21.3.1996; nr. 8830, datë 5.11.2001; nr. 9261, datë 22.7.2004; nr. 9667, datë 29.12.2006; nr. 10 173, datë 11.5.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KAPITULLI I
EMËRTIMI DHE FUSHA E PËRDORIMIT TË TIJ

Neni 1

Ky është ligji mineral i Shqipërisë (1994).

Neni 2

Fusha e shtrirjes së këtij ligji është gjithë territori i Republikës së Shqipërisë duke përfshirë dhe pjesët nënujore dhe nëntokësore që janë në juridiksionin e saj.

KAPITULLI II
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 3

(Hequr fjalë me ligjin nr. 8093, datë 21.3.1996; ndryshuar term dhe shtuar një paragraf me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004; shtuar një paragraf me ligjin nr. 9667, datë 29.12.2006)

Në këtë ligj, nëse nuk thuhet ndryshe në kontekst:

“Shtet” nënkupton: Republikën e Shqipërisë.

“Ministër” nënkupton: Anëtarin e Këshillit të Ministrave, i cili për kohën që mban këtë post është përgjegjës për industrinë minerare.

“Ministri” nënkupton: Ministrinë që mbulon industrinë minerare.

“Person” nënkupton: Një person juridik ose fizik.

“Mineral” nënkupton çdo substancë të dobishme, në gjendje të ngurtë, të lëngët ose të gaztë, që ndodhet në trajtë natyrore, mbi tokë ose nën tokë, në ujë ose nën ujë, në sterilet e minierave të shfrytëzuara apo në dambat e fabrikave të pasurimit, skorjet e metalurgjisë së zezë dhe me ngjyrë, të formuar prej proceseve gjeologjike, duke përfshirë naftën, në gjendje të lëngët, gazin natyror, në gjendje të gaztë dhe ujin, por duke përfshirë rërën, gurët, shkëmbinjtë, zhavorrin dhe argjilat.

Rërat, zhavoret, zhurët trajtohen, sipas këtij ligji, në rastet kur nuk përfshihen në përcaktimet e bëra në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”.

“Veprimtari minerare” nënkupton të gjitha punët, që lidhen me kërkimin, zbulimin,

zhvillimin, shfrytëzimin, përpunimin, tregtimin e produkteve minerare, si dhe kujdesin, mirëmbajtjen, monitorimin ose mbylljen e minierave, duke pasur parasysh edhe rehabilitimin e mjedisit.

“Minierë” nënkupton:

1. Çdo germim mbi ose nën tokë duke përfshirë edhe pjesët nën ujë dhe sterilet, si dhe çdo shpim ose pus kërkim-zbulimi, i cili është në punë ose jo i bërë për qëllim kërkimi ose shfrytëzimi të mineralit.

2. Çdo vend ku shfrytëzohet një pasuri minerare, duke përfshirë këtu zonën minerare dhe të gjitha ndërtesat, strukturat, makineritë, dambat, rrugë ose objekte të tjera të vendosura në një zonë të tillë, të cilat përdoren ose kanë si qëllim të përdoren për kërkimin, përfitimin, shfrytëzimin ose përpunimin e një minerali të tillë.

“Nëntokë” në lidhje me një minierë nënkupton: Çdo vend në një minierë që ndodhet në sipërfaqen natyrore të tokës, i cili lidhet me sipërfaqen e tokës me anën e një pusi vertikal, traverbanku, pusi qorr, tuneli, dishenteri ose një kombinimi të tyre.

“Karierë” nënkupton: Çdo vend (përveç minieres nëntokësore) ku nxirren materiale ose minerale direkt nga sipërfaqja me anë të gërmimit ose mënyrave të tjera për të siguruar materiale për ndërtim, tregti, për qëllime industriale ose përpunuese.

“Shfrytëzim minerali” nënkupton: Kryerjen e çdo gërmimi, shpimi apo pusi kërkimi sipas paragrafit 1 të këtij neni ose shfrytëzimi i çdo vendburimi mineral me çfarëdo lloji mënyre, me qëllim nxjerrjen e një minerali, duke përfshirë kërkimin dhe zbulimin brenda një trupi mineral.

“Përpunim” në lidhje me një mineral nënkupton: Përpunimin e mineralit deri në produkt të gatshëm duke përfshirë nxjerrjen, proceset e pasurimit, rafinimin, kalçimin, shkrirjen, gazifikimin e tij etj.

“Leje minerare” nënkupton: Një leje, të dhënë në përputhje me këtë ligj për t’u futur në aktivitetet që lidhen me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve.

“Marrëveshje lehtësuese” nënkupton: Një marrëveshje ndërmjet zotëruesit të lejes dhe Ministrisë në përputhje me nenin 44.

“Interes publik” nënkupton: Diçka ku shoqëria, njerëzit në përgjithësi, kanë disa interesa financiare, të cilat ndikojnë në të drejtat ose mundësitë legale të tyre.

“Renta e pasurisë minerare” (Royalty) nënkupton: Pagesën në përqindje të vlerës së mineralit të shitur që i paguhet shtetit.

“Datë efektive” nënkupton datën në të cilën leja nënshkruhet nga Ministri.

“Monitorim postmineral” nënkupton një proces për vëzhgimin dhe kontrollin e ndryshimit të parametrave fiziografikë, kimikë, gjeoteknikë, si dhe për vlerësimin e efekteve të mundshme të shfrytëzimit mineral, pas mbylljes ose braktisjes së një miniere.

Neni 4

Ky ligj përcakton marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personave juridikë dhe fizikë me qëllim që të përfitohen të drejtat minerare dhe të ekzekutohen aktivitetet minerare. Të përjashtuar nga zbatimi i këtij ligji janë nafta që është në gjendje të lëngët, gazi natyror që është në gjendje të gaztë dhe ujrë.

Neni 5

Të gjitha të drejtat minerare të siguruar në përputhje me këtë ligj dhe ushtrimi i çdo aktiviteti mineral në Shqipëri duhet të mbështeten në legjislacionin shqiptar.

Neni 6

Aktivitetet e kryera në përputhje me të drejtat minerare deklarohen të jenë për interes publik me qëllim që të mundësohet përdorimi i tokës.

Neni 7

Shteti nxit zhvillimin dhe modernizimin e sektorit minerar në Shqipëri, në kushtet e ekonomisë së tregut, të bazuar në konkurrencën dhe në iniciativën e lirë.

KAPITULLI III AUTORITETI I SHTETIT DHE TË DREJTAT MINERARE

Neni 8

Të gjitha mineralet që ekzistojnë në trajtë natyrore në territorin ku vepron ky ligj, pavarësisht nga origjina e tyre, forma ose gjendja fizike, nën ose mbi sipërfaqen e tokës, në thellësi ose në ujrat, janë pasuri të patundshme të shtetit, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse.

Neni 9

Shteti u jep të drejtat minerare në përputhje me këtë ligj personave fizikë ose juridikë vendas ose të huaj, duke i lejuar zotëruesit të së drejtës minerare të kryejnë aktivitetet minerare.

Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitet minerar përveç atyre që zotërojnë të drejtat e siguruar nga ky ligj.

Neni 9/1

(Shtuar me ligjin nr. 10 173, datë 11.5.2009)

Të drejtat minerare, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë IV.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Të drejtat minerare jepen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

Neni 10

(Shtuar një paragraf me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Kur Ministri ose i autorizuari prej tij, gjykon që dhënia e të drejtave minerare në përputhje me këtë ligj mund të ndikojë seriozisht dhe të ketë kontradita me banorët e rajonit përkatës, përpara se të japë ndonjë të drejtë të tillë duhet të konsultohet me autoritetet përkatëse lokale.

Në zonat e shpallura nga Këshilli i Ministrave si “gjeomonumente dhe terrene me vlera të veçanta natyrore”, e drejta minerare jepet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Çdo e drejtë minerare e dhënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të ushtrohet në përputhje me këtë ligj.

Neni 12

Një leje minerare është një e drejtë e paprekshme, e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronarit të tokës. Duke qenë objekt i miratimit të dhënë me përpara me shkrim nga Ministri, të drejtat që rrjedhin nga leja minerare mund të transferohen dhe mund të jepen me kushte. Ndërtimet dhe instalimet e tjera, që ndikojnë në operacionet kryesore konsiderohen si aktivitete ndihmëse të patundshme të së drejtës minerare.

Neni 13

Asnjë e drejtë minerare nuk autorizon zotëruesin e saj që të përdorë nëntokën, pusët, traverbanket, galeritë, shpimet ose punimet e tjera nëntokësore për ndonjë qëllim tjetër i cili nuk është specifikuar në lejen e dhënë. Përdorimi i nëntokës ose punimeve nëntokësore për depozitimin, hedhjen e mbeturinave toksike, radioaktive ose mbeturinave të tjera të kësaj natyre është i ndaluar.

Çdo pasuri kulturore, monetare, historike, arkeologjike etj., që gjendet në zonën e lejuar për kryerjen e aktiviteteve minerare është pronë e shtetit dhe i përkasin shtetit. Zotëruesi i lejes minerare, në rast se gjen pasuritë e mësipërme njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave.

KAPITULLI IV GRUPIMI I MINERALEVE

Neni 14

Për qëllim të këtij ligji, mineralet janë ndarë në grupet e mëposhtme:

- a. Grupi i parë- Mineralet metalore
- b. Grupi i dytë- Mineralet jometalore
- c. Grupi i tretë- Qymyret dhe bitumet
- d. Grupi i katërt- Mineralet dhe materialet për ndërtim
- e. Grupi i pestë- Gurët e çmuar
- f. Grupi i gjashtë- Gurët gjysëm të çmuar

Mineralet që i përksin secilit grup janë shënuar në tabelën A, e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji.

KAPITULLI V ADMINISTRIMI

Neni 15

Ministri është autoriteti kompetent për të vepruar në emër të shtetit për ekzekutimin e këtij ligji.

Neni 16

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004; ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9667, datë 29.12.2006)

Për t'i shërbyer zbatimit të dispozitave të këtij ligji në fushën e aktiviteteve minerare në Shqipëri krijohet Drejtoria e Përgjithshme e Minierave.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është enti i specializuar, i cili siguron asistencë teknike për ministrinë, nëpërmjet oponencave, monitorimeve dhe veprimtarive të tjera, që kanë lidhje me këtë ligj.

Neni 17

Ministri në zbatim të këtij ligji nxjerr aktet e nevojshme nënligjore.

KAPITULLI VI SHOQËRITË QË USHTROJNË VEPRIMTARI MINERARE (Ndryshuar titulli me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Neni 18

(Ndryshuar me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Veprimtaritë minerare që lidhen me projektimin, administrimin, kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, ushtrohen nga shoqëritë tregtare, persona juridikë, me përjashtim të rasteve që parashikohen në nenet 66 dhe 69 të këtij ligji.

Neni 19

(Ndryshuar me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Shoqëritë koncesionare, të përfshira në veprimtaritë minerare, u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Neni 20

(Ndryshuar me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9667, datë 29.12.2006; zëvendësuar fjalë dhe shtuar një paragraf me ligjin nr. 10 173, datë 11.5.2009)

Veprimtaria minerare, në tërësi, që lidhet me projektimin, vlerësimin, këshillimin, monitorimin dhe drejtimin teknik të shoqërive, kryhet nga specialistë të pajisur me certifikatë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni kur kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, përfshihen në kategorinë IV.4 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit të licencave.

KAPITULLI VII TË DREJTAT MINERARE PËR GRUPET 1,2 DHE 3 TË MINERALEVE

A) LEJA E KËRKIMIT

Neni 21

Pas kërkesës së personit Ministri mund t'i japë këtij një leje kërkimi, forma e së cilës përshkruhet në rregullore. Pas kësaj zotëruesi i lejes ka të drejtën ekskluzive të kërkojë brenda zonës së lejuar për shfaqje të mineraleve.

Neni 22

Zona e lejuar për kërkim nuk duhet të kalojë 400 km², të jetë një e tërë dhe nuk duhet të mbulojë ndonjë zonë e cila është objekt i një leje tjetër kërkimi, një leje zbulimi ose një leje shfrytëzimi e dhënë në përputhje me këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur zotëruesi i një lejeje të tillë ekzistuese jep më parë pëlqimin e tij me shkrim.

Neni 23

Afati maksimal do të jetë një vit dhe nuk është objekt i një shtyrjeje tjetër në kohë.

Neni 24

Një person mund të mbajë më shumë se një leje kërkimi njëkohësisht.

Neni 25

Kërkesa për një leje kërkimi duhet të përmbajë:

- a. Emrin dhe adresën e kërkuesit.
- b. Specifikime të burimeve financiare dhe aftësive teknike që i vlejnë kërkuesit për marrjen e lejes, si dhe eksperiencën e tij në fushën e industrisë minerare.
- c. Një përshkrim të zonës që kërkohet, duke përfshirë dhe një hartë.
- d. Specifikimet e programit të kërkimit të propozuar për t'u kryer, metodat e propozuara të punës, një vlerësim i kostove dhe afateve të kryerjes së programit.

Neni 26

Brenda gjashtëdhjetë ditësh pas marrjes së kërkesës, Ministri duhet të njoftojë kërkuesin për vendimin e tij në lidhje me kërkesën e të interesuarit për leje kërkimi.

Neni 27

Leja e kërkimit i jep zotëruesit të saj këto të drejta:

- a. Hyrjen në zonën e lejuar me punonjësit, mjetet, makineritë, pajisjet që janë të nevojshme ose të domosdoshme për kryerjen e kërkimit të mineraleve mbi ose nën tokë;
- b. Kërkimin e mineraleve, kryerjen e operacioneve dhe punimeve të nevojshme, me kusht që zotëruesi i lejes nuk mund të angazhohet në shpim, gjermim ose në teknika të tjera nëntokësore për të cilat ai nuk është i autorizuar sipas lejes së tij të kërkimit për përdorimin e këtyre teknikave;
- c. Nxjerrjen dhe lëvizjen e mostrave minerale nga toka në sasi jo komerciale, por vetëm për studime.

Neni 28

Përveç kushteve të tjera të detyruara në lejen e kërkimit, çdo leje kërkimi është objekt i pikave të mëposhtme:

- a. Zotëruesi i lejes duhet të raportojë shpejt me shkrim tek Ministri mbi gjetjen e të gjithë mineraleve me interes ekonomik;
- b. Të gjitha prishjet e sipërfaqes së tokës që janë bërë gjatë kërkimit duhet të sillen në gjendjen e mëparshme, e cila quhet e kryer pasi është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e

Minierave;

c. Zotëruesi i lejes duhet të marrë gjithë masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e bimësisë ose pasurive të tjera.

Neni 29

Zotëruesi i lejes, në kohë dhe në mënyrë të përcaktuar në bazë të rregulloreve, i raporton Drejtorisë së Përgjithshme të Minierave mbi punën e bërë në zonën e kërkimit, shpenzimet dhe rezultatet. Një pjesë përfaqësuese e kampionit gjeologjik të marrë nga ai i jepet Drejtorisë së Përgjithshme të Minierave së bashku me rezultatet e të gjitha provave dhe trajtimeve që i janë bërë kampionit.

B) LEJA E ZBULIMIT

Neni 30

Ministri, pas kërkesës së personit që konsiderohet se ka burime të mjaftueshme financiare, teknike dhe eksperiencë minerare, mund t'i japë këtij kërkuesi një leje zbuluese, që i garanton atij të drejtën ekskluzive të zbulojë mineralet e specifikuara në zonën e tij të lejuar.

Forma e lejes së zbulimit përcaktohet sipas rregulloreve.

Neni 31

Kërkesa për një leje zbuluese duhet të përmbajë:

- a. Emrin dhe adresën e kërkuesit;
- b. Eksperiencën e tij në zbulimin e mineraleve;
- c. Burimet ekzistuese financiare dhe teknike, që i vlejnë kërkuesit të lejes së zbulimit për marrjen e saj;
- ç. Zonën e propozuar për leje duke përfshirë dhe një hartë të saj;
- d. Minerali ose grupet e mineraleve (Grupi i 1,2 ose 3) për të cilët kërkohet leja; dh. Mënyra e propozuar e zbulimit;
- e. Programi i propozuar i punës dhe një plan pune me afatet së bashku me shpenzimet e parashikuara që do të kryhen për realizimin e tij, si dhe një program minimal pune, i cili duhet të jetë i garantuar nga një garantues që miratohet nga Ministri.

Neni 32

Zotëruesi i një leje kërkimi do të ketë përparësi ndaj kërkuesve të tjerë për një leje zbulimi që ndodhet në zonën e tij të lejuar të kërkimit, gjatë afatit të lejes së tij të kërkimit dhe për një periudhë prej tridhjetë ditësh pas skadimit të saj, me kusht që Ministrit t'i plotësohen nga kërkuesi i lejes pikat (b), (c), (dh), (e) të nenit 31.

Neni 33

Ministri brenda gjashtëdhjetë ditëve pas marrjes së kërkesës, duhet të njoftojë kërkuesin e lejes së zbulimit për vendimin e tij në lidhje me këtë kërkesë.

Neni 34

Afati fillestar i lejes së zbulimit është dy vjet dhe bëhet objekt i tre shtyrjeve, secila nga

një vit nëse kërkohet nga zotëruesi i lejes. Kërkesa për shtyrje afati duhet të paraqitet së paku 30 ditë para mbarimit të periudhës së mëparshme.

Këto shtyrje në afat do të jepen nëse Ministri vlerëson se zotëruesi i lejes së zbulimit ka plotësuar më parë detyrimet financiare në përputhje me lejen që i është dhënë dhe paraqet një program pune bindës për vazhdimin e mëtejshëm të zbulimit.

Neni 35

Brenda nëntëdhjetë ditëve pas datës efektive të lejes së zbulimit zotëruesi i saj duhet të fillojë punimet në teren.

Neni 36

Zona maksimale e lejuar në një leje zbulimi është 200 km² dhe një e tërë. Ajo nuk duhet të mbulojë zona që janë objekt i licencave kërkimore, të zbulimit ose të shfrytëzimit të personave të tjerë, me përjashtim të rastit kur Ministri dhe zotëruesit e tjerë të lejeve bien dakord që leja e re nuk do të ndikojë në të drejtat e kontratave ekzistuese.

Neni 37

Një zotërues i lejes së zbulimit mund të ketë më shumë se një të tillë njëkohësisht.

Neni 38

Zotëruesi i lejes së zbulimit duhet të lërë pjesë të zonës së tij të lejuar të zbulimit në mënyrë progresive në përputhje me afatet.

- a. Deri në fund të afatit fillestar zotëruesi lë së paku 40% të zonës së lejuar fillestare.
- b. Deri në fund të shtesës së parë në afat prej një viti zotëruesi lë së paku 50% të zonës së lejuar fillestare.
- c. Deri në fund të shtesës së dytë në afat prej një viti zotëruesi lë së paku 70% të zonës së lejuar fillestare.
- d. Deri në fund të shtesës së tretë prej një viti (deri në fund të vitit të pestë) lë të gjitha pjesët e zonës së lejuar fillestare që nuk mbulohen nga një leje shfrytëzimi minerar.

Neni 39

Çdo shtesë një vjeçare të kërkuar nga zotëruesi i lejes së zbulimit duhet të miratohet nga Ministri si kusht për zgjatjen e lejes së zbulimit. Pas këtij miratimi zyrtar nga Ministri zotëruesi i lejes ka të drejtë të vazhdojë zbulimin.

Neni 40

(Ndryshuar shprehje me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Zotëruesi i lejes së zbulimit duhet t'i paguajë shtetit një pagesë vjetore për zonën e tij të zbulimit. Kjo pagesë paguhet në datën efektive të dhënies së lejes së zbulimit dhe në çdo vit në këtë datë efektive në varësi të km² të përfshirë në zonën e lejuar të tij të zbulimit në kohën e pagimit të kësaj pagese. Pagesa vjetore që përfshin zonën e zbulimit duhet specifikuar në lejen e zbulimit dhe është 30 000 lekë në momentin e pagesës.

Neni 41

Leja e zbulimit i jep zotëruesit të saj këto të drejta:

- a. Të futet në zonën e lejuar me punonjës, mjete, makineri dhe pajisje të nevojshme për qëllim zbulimi të mineraleve mbi ose nën tokë.
- b. Të zbulojë minerale dhe të kryejë punë të tilla të nevojshme për këtë qëllim, siç mund të jenë puse kërkimi, transhe, bira me dimensione të vogla dhe të mëdha, si dhe punime kërkimi mbi ose nën tokë.
- c. Të nxjerrë, të lëvizë dhe të eksportojë nga zona e lejuar provat e mineraleve në sasi jo komerciale për qëllime studimore.

Neni 42

Zotëruesi i lejes së zbulimit duhet të bëjë regjistrim të plotë dhe të detajuar të punës së kryer për zbulimin e mineraleve dhe operacioneve të tjera në përputhje me lejen e tij të zbulimit dhe këto regjistrime të jenë në çdo moment të vlefshme për inspektim në Shqipëri nga organet kompetente të përcaktuara nga Ministri.

Zotëruesi i lejes së zbulimit pajis Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave me kopjen e një informacioni të tillë që lidhet me zbulimin dhe operacionet e tjera të kryera nga ai sipas kërkesës së saj.

Detyrimet e neneve 28 dhe 29 zbatohen dhe për zotëruesin e lejes së zbulimit.

Neni 43

Zotëruesi i lejes së zbulimit ka të drejtë që gjatë afatit të kësaj leje, pjesë të zonës së tij të lejuar të zbulimit t'i konvertojë në një ose më shumë leje shfrytëzimi duke i përjashtuar këto pjesë nga detyrimet e lejes së zbulimit.

Kërkesa për një leje shfrytëzimi plotësohet në përputhje me nenin 45.

C) LEJA E SHFRYTËZIMIT

Neni 44

Ministri, pas kërkesës së personit që konsiderohet se ka burime të mjaftueshme financiare, teknike dhe eksperience minerare, mund t'i japë këtij kërkuesi një leje shfrytëzimi që i garanton atij të drejtën ekskluzive të shfrytëzojë një ose më shumë minerale të specifikuar në zonën e tij të lejuar. Dokumenti i lejes së shfrytëzimit përcaktohet sipas rregulloreve.

Ministri është i autorizuar të negociojë dhe të hyjë në tratativa për nënshkrimin e një marrëveshjeje lehtësuese me zotëruesin e lejes.

Një marrëveshje e tillë miratohet nga Këshilli i Ministrave kur është në kompetencë të tij dhe nga Kuvendi Popullor për lehtësira që nuk parashikohen në legjislacionin në fuqi.

Neni 45

Kërkesa për një leje shfrytëzimi duhet:

- a. Të ketë emrin dhe adresën e kërkuesit.
- b. Të specifikojë zonën për të cilën kërkohet leja e shfrytëzimit, duke përfshirë këtu dhe një hartë.
- c. Të specifikojë mineralin ose mineralet në grupet 1,2 ose 3 për të cilët kërkohet leja e shfrytëzimit.

ç. Të japë detaje të vendburimeve minerale në zonat për të cilat kërkohet leje shfrytëzimi, duke përfshirë këtu detaje të të gjithë mineraleve të zbuluar, të rezervave minerare të kategorive të ndryshme dhe kushtet minerare të shfrytëzimit.

d. Të shoqërohet me një raport teknik mbi shfrytëzimin, trajtimin e mineraleve me mundësitë e rritjes së vlerës së tyre në Shqipëri dhe qëllimin e kërkuesit në lidhje me to.

dh. Të sigurojë propozimin e një programi pune së bashku me afatet për zhvillimin e punimeve dhe investimet.

e. Të japë detaje të operacioneve minerare të propozuara duke përfshirë këtu:

(i) kapacitetin e llogaritur të prodhimit me shkallëzimin e operacioneve të punës;

(ii) llojet e produkteve;

(iii) propozimet për ndalimin e ndotjes, trajtimin e sterileve, mbrojtjen e pasurive natyrore, reklamimin dhe rehabilitimin progresiv të tokës së dëmtuar të shkaktuar nga shfrytëzimi mineral dhe për minimizimin e efekteve të shfrytëzimit mineral mbi ujrat sipërfaqësore, të ujrave nëntokësore dhe tokave të zonave fqinje në zonën e lejuar;

(iv) efektet që mund të ndodhin mbi ambientin nga operacionet minerare dhe propozimet për minimizimin e tyre;

(v) ndonjë rrezik të veçantë (për shëndetin ose diçka tjetër) që mund të lindë gjatë shfrytëzimit të mineraleve dhe propozimet për kontrollin dhe eliminimin e tyre.

ë. Të japë një parashikim të detajuar të investimeve kapitale, të kostove të punës, të të ardhurave dhe tipin e parashikuar të burimeve financiare.

f. Të japë specifikime të propozimeve të tij në lidhje me punësimin edhe specializimin e shtetasve shqiptarë.

g. Të japë specifikime mbi kërkesat e pritshme të infrastrukturës dhe masave paraprake që do të marrë.

Neni 46

Kur kërkuesi i lejes së shfrytëzimit nuk është zotëruesi i lejes së zbulimit, kërkesa duhet të përfshijë detaje të plota dhe të hollësishme të kapacitetit financiar dhe teknik të kërkuesit dhe informacion në lidhje me eksperiencën e tij në fushën minerare.

Neni 47

(Hequr fjalë në fund të paragrafatit të dytë dhe shtuar fjalë me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Ministri duhet të njoftojë kërkuesin e lejes së shfrytëzimit për vendimin e tij mbi kërkesën, brenda nëntëdhjetë ditësh pas marrjes së saj. Një vendim i tillë në lidhje me kërkesën e kërkuesit të lejes së zbulimit merret në përputhje me nenin 45.

Ministri duhet të sigurohet se toka që jepet për shfrytëzimin mineral është survejuar siç duhet më parë se të jepet leja e shfrytëzimit. Për këtë qëllim Ministri mund të drejtojë kërkuesin e lejes së shfrytëzimit që të përgatisë një survejim me shpenzimet e vetë kërkuesit në lidhje me kërkesa që specifikohen në rregulloren e miratuar prej tij.

Të gjitha lejet për shfrytëzim mineral duhet të bëhen publike nëpërmjet shtypit dhe mjeteve të tjera të informacionit.

Neni 48

(Shtuar shprehje me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Zona maksimale e lejuar për leje shfrytëzimi mineral është 15 km² dhe një e tërë e përcaktuar në hapësirë, sipas 3 koordinatave. Një zotërues leje shfrytëzimi mineral mund të

ketë më shumë se një të tillë njëkohësisht.

Neni 49

Periodha e lejes së shfrytëzimit mineralar është deri njëzet vjet, duke filluar nga data efektive e saj, dhe është subjekt i katër shtesave deri në pesë vjet secila, nëse këto kërkohen nga zotëruesi i lejes në një kohë jo më pak se një vit para datës së skadimit të periudhës së mëparshme.

Neni 50

(Zëvendësuar shprehje me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineralar duhet t'i paguajë shtetit në datën efektive të dhënies së lejes së shfrytëzimit dhe në çdo vit në të njëjtën datë një pagesë vjetore për zonën e tij të lejuar për shfrytëzim. Vlera e kësaj pagese të përcaktohet nga Ministri në kohë të ndryshme për çdo leje shfrytëzimi sipas kritereve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Pagesa vjetore për një leje shfrytëzimi mineralar ka si vlerë minimale 300 000 lekë dhe, në vlerën maksimale, 1 000 000 lekë për një km².

Neni 51

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineralar, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas mbarimit të çdo muaji kalendarik, duhet t'i paguajë shtetit në lekë ekuivalentin të frangës zviceriane, një rente pasurie minerare (royalty) prej 2% të vlerës së tregut për sasinë e përgjithshme të mineralit të shitur tek konsumatorët gjatë këtij muaji kalendarik dhe të prodhuar nga zona e tij e lejuar. Procedura e përcaktimit të vlerës së tregut të mineraleve përcaktohet në rregullore.

Neni 52

(Shtuar fjalë në fund të shkronjës "c" me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Leja e shfrytëzimit mineralar i jep zotëruesit të saj këto të drejta:

a. Të kryejë veprimet e nevojshme për të realizuar me efektivitet operacionet minerare në zonën e tij të lejuar për shfrytëzim;

b. të nxjerrë dhe të lëvizë nga zona e tij e lejuar mineralin ose mineralet për të cilat i është dhënë leja e shfrytëzimit;

c. të instalojë dhe të verë në punë brenda zonës së tij të lejuar fabrika pasurimi, shkrirësa, rafineri dhe fabrika të tjera që rrisin vlerën e mineraleve të nxjerra në zonën e tij të lejuar për shfrytëzim pasi të kenë marrë lejet përkatëse për veprimtari të tilla, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 53

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineralar ka të drejtë të ndërtojë, instalojë dhe verë në punë brenda zonës së tij të lejuar ndërtesa, kampe, ambiente depozituese, tubacione, gjeneratorë elektrik, pajisje transmisioni, sisteme komunikimi, hekurudha, pajisje depozitimi të karburanteve dhe infrastruktura të tjera të nevojshme për operacionet e punës.

Neni 54

Shteti nuk ka detyrim të sigurojë ndonjë infrastrukturë brenda ose jashtë zonës së lejuar. Kur zotëruesi i lejes dëshiron të përdorë ambientet ose infrastrukturën që i përket shtetit dhe që

përdoren për qëllime publike ai ka të drejtë ta përdorë këtë infrastrukturë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 55

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral ka të drejtë pa leje ose autorizim tjetër të shesë në Shqipëri ose të përdorë për eksport mineralet e prodhuara, produktet përfundimtare dhe nënproduktet e tyre, në përputhje me lejen e shfrytëzimit mineral për zonën e tij lejuar.

Neni 56

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral duhet të paraqesë raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera në përputhje me lejen e tij të shfrytëzimit mineral dhe i bën këto raporte të vlefshme në çdo kohë për inspektim nga organet kompetente të përcaktuara nga Ministri.

Neni 57

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral duhet të mbajë në Shqipëri dokumentacionin e plotë, si dhe informacione të tjera për të treguar punën e kryer në përputhje me lejen, llogarinë rrjedhëse, sasinë, cilësinë dhe vlerën e të gjitha mineraleve të nxjerra nga zona e lejuar e shfrytëzimit. I gjithë ky dokumentacion, përfshirë këtu dhe anën financiare, duhet të mbahet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me një praktikë të pranueshme që përdoret në industrinë minerare ndërkombëtare.

Neni 58

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral duhet t'i paraqesë Drejtorisë së Përgjithshme të Minierave të dhëna teknike, operative dhe të prodhimit në formë dhe intervale kohe të përcaktuara në rregullore.

Neni 59

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral duhet t'i paraqesë Ministrit për miratim një program pune vjetor, buxhetin dhe planin e prodhimit për zonën e tij të lejuar të shfrytëzimit.

Një program i tillë si fillim duhet të mbulojë planin e punës së periudhës së vitit kalendarik në të cilën ndodhet data efektive e dhënies së lejes dhe duhet të paraqitet jo më vonë se tridhjetë ditë nga kjo datë. Për çdo vit që vjen, dorëzimi duhet të bëhet së paku nëntëdhjetë ditë më parë se viti kalendarik me të cilin lidhet programi i propozuar, buxheti dhe plani i prodhimit.

Dorëzimi nga ana e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit mineral quhet i mirëqenë nëse Ministri nuk merr brenda dyzetë ditëve nga data e dorëzimit ndonjë ndryshim me shkrim për programin e sipërpërmendur.

Neni 60

Kur Ministri konsideron se zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral po përdor praktika të dëmshme të shfrytëzimit të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, ose po drejton operacionet e punës në kundërshtim me objektivin e shfrytëzimit optimal të minierave, ai njofton zotëruesin e lejes (duke e njoftuar në detaje për një praktikë të tillë) dhe i kërkon atij brenda një afati të

caktuar kohe shpjegimet e nevojshme.

Nëse brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e paragrafit të parë, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral nuk plotëson kërkesat e specifikuar, Ministri nxjerr urdhër për të detyruar zotëruesin e lejes së shfrytëzimit mineral të marrë masa, që brenda një kohe të caktuar të përmbushë kërkesat e parashtruara prej tij.

Neni 61

Në rastet kur Ministri vëren se përdoret ose tentohet të përdoret sipërfaqja e tokës, që sipas opinionit të Ministrit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në objektin e këtij ligji në lidhje me shfrytëzimin optimal të ndonjë minerali, që ndodhet ose që mund të ndodhet në sasi ekonomikisht të shfrytëzueshme në ose mbi këtë tokë, ose mbi sterilet e kësaj toke, Ministri ndërhyr për këtë problem dhe merr masat e nevojshme konform legjislacionit në fuqi.

Neni 62

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineral njofton Ministrin:

- a. një vit më parë nëse propozohet të ndalohet prodhimi prej një miniere në zonën e lejuar në fjalë;
- b. njëqind e tetëdhjetë ditë më parë nëse propozohet të pezullohet prodhimi prej një miniere të tillë;
- c. nëntëdhjetë ditë më parë nëse propozohet të zvogëlohet prodhimi i një miniere të tillë për më shumë se 10% të prodhimit të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit.

Ky njoftim duhet të përmbajë të detajuar arsyen ose arsyet për ndalimin, pezullimin ose uljen e prodhimit të një miniere të tillë.

KAPITULLI VIII TË DREJTAT MINERARE PËR GRUPIN E 4-T TË MINERALEVE DHE MATERIALEVE TË NDËRTIMIT

A) LEJA E KËRKIM-ZBULIMIT

Neni 63

(Zëvendësuar shprehje me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Ministri, pas kërkesës së ndonjë personi që konsiderohet se ka burime të mjaftueshme financiare dhe eksperiencë teknike me grupin e 4-t të mineraleve, mund t'i japë këtij personi një leje që përshkruhet në rregullore, me anë të të cilit ky person ka të drejtën ekskluzive të kërkojë ose të zbulojë brenda zonës së tij të lejuar për minerale të grupit të 4-t që mund të jenë baza për hapjen e një kariere të tipit të dytë.

Një leje e tillë në kohë ka si maksimum 2 vjet dhe në sipërfaqe një maksimum prej 30 km². Zgjatja e lejes varet nga specifikat e aktivitetit që personi kërkon të kryej.

Një person mund të mbajë më shumë se një leje të tillë njëkohësisht. Në rastin kur leja është për zbulim, personi duhet t'i paguajë shtetit në datën efektive të marrjes së lejes një pagesë me vlerë 10 000 lekë për km² të zonës së tij të lejuar.

Neni 64

Kërkesa për një leje kërkimi ose zbulimi për mineralet e grupit të 4-t duhet të përmbajë:

- a. emrin dhe adresën e kërkuesit;

- b. burimet ekzistuese financiare dhe teknike, eksperiencën e tij në kërkim-zbulimin e mineraleve të grupit të 4-t;
- c. zonën e propozuar për leje duke përfshirë dhe një hartë;
- ç. mineralet e grupit të 4-t për të cilat kërkuesi ka interesin kryesor;
- d. mënyrën e propozuar të zbulimit si dhe programin e punës me afatet së bashku me shpenzimet e parashikuara që do të kryhen për realizimin e tij.

Neni 65

Ministri, brenda gjashtëdhjetë ditëve pas marrjes së kërkesës, duhet të njoftojë kërkuesin e lejes së zbulimit për vendimin e tij në lidhje me këtë kërkesë.

B) LEJA E SHFRYTËZIMIT

Neni 66

Një leje për shfrytëzim me karierë kërkohet për shfrytëzimin e mineraleve dhe materialeve të ndërtimit me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- a. Kur pronari i sipërfaqes së tokës merr materiale prej sipërfaqes së kësaj toke dhe i përdor për ndërtim në tokën e tij.
- b. Kur autoritetet lokale ose persona të tjera të përfshirë në ndërtimin e rrugëve publike ose në ndërtime të tjera publike përdorin mbeturinat nga gërmimet e nevojshme ose nga gërmimi i puseve të zbulimit ngjitur me rrugë ose punë të tilla.
- c. Kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit mineralar merr materiale ndërtimi prej zonës së tij dhe i përdor në operacionet e tij minerare.

Neni 67

Ministri vendos për çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlerësimet e bëra nga personi që ka kryer inspektimin sipas nenit 66. Urdhri i tij është i formës së prerë për çështjen.

Neni 68

Ministri me anë të një akti nënligjor përcakton vendin e ndërtimit të karierave për qëllime publike (tipi I). Çdo karierë për ndërtime publike, për veprimtarinë e saj është nën kontroll nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Minierave.

Neni 69

(Shtuar paragraf pas shkronjës “b” me ligjin nr. 8830, datë 5.11.2001; hequr shprehje në shkronjën “b” me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Autorizohen të jepen dy tipe leje karierash:

- a. Tipi i parë i lejes së karierës - është një leje që lejon të shfrytëzohen mineralet dhe materialet e ndërtimit nga një karierë publike kundrejt një pagese (që do të caktohet nga Ministri në lejen e dhënë, vlera e kësaj pagese është përcaktuar në rregullore). Afati fillestar maksimal i tipit të parë të lejes së karierës është një vjeçar, objekt i rinovimit (të lejes së karierës) çdo gjashtë muaj njëra pas tjetrës sipas kërkesës së zotëruesit, e cila duhet të paraqitet së paku tridhjetë ditë përpara mbarimit të periudhës së mëparshme.
- b. Tipi i dytë i lejes së karierës - është një leje ekskluzive për të hapur dhe shfrytëzuar

një karrierë për mineralet ose materialet e ndërtimit me pagesë (që do të caktohet nga Ministri në lejen e dhënë, vlera e kësaj pagese është përcaktuar në rregullore). Afati fillestar maksimal i tipit të dytë të lejes së karrierës është dhjetë vjet, objekt i rinovimit të saj çdo një vit (njëri pas tjetrit) sipas kërkesës së zotëruesit (të lejes së tipit të dytë të karrierës).

Në raste të veçanta, kur afati i dhënies së lejes minerare të shfrytëzimit kërkohet deri në 99 vjet, ministria përkatëse negocion marrëveshjen me lejekërkuesin, miratimin e së cilës e bën Këshilli i Ministrave.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të miratohet edhe nga Kuvendi.

Neni 70

Kërkesa për të marrë lejen për karrierat duhet të përfshijë:

- a. Emrin dhe adresën e kërkuarit.
- b. Të përcaktohen mineralet ose materialet e grupit të katërt, për të cilat kërkohet leja.
- c. Të specifikohet afati fillestar për të cilin kërkohet leja.
- ç. Të sigurohen detaje të burimeve financiare të vlefshme për kërkuarin e lejes me qëllim që ky të paguaj shpenzimet e shfrytëzimit të mineraleve dhe materialeve të ndërtimit.
- d. Në rastin e tipit të parë të lejes së karrierës, të tregohen sasi të minimale dhe maksimale vjetore të prodhimit, specifikimet për çdo mineral ose material për të cilin kërkohet leja.
- dh. Në rastin e tipit të dytë të lejes së karrierës kërkohet gjithashtu:
 1. të specifikohet vendosja e saktë e karrierës së propozuar nga kërkuari i lejes;
 2. të jepen detaje mbi vendburimin për të cilin kërkohet leja e karrierës;
 3. të sigurohet një program i propozuar shfrytëzimi dhe investimi dhe një plan pune me afate;
 4. të jepet një parashikim i detajuar i investimeve kapitale, shpenzimeve të punës dhe të të ardhurave, si dhe tipi i parashikuar i burimeve financiare;
 5. të japë hollësi mbi kërkesat e pritshme të infrastrukturës dhe masat paraprake për rregullimin e saj;
 6. të sigurojë një listë të detajuar të mineraleve dhe materialeve të ndërtimit që do të prodhohen nga kariera, kapaciteti i llogaritur i prodhimit, shkallëzimi i operacioneve dhe tregjet e planifikuara për shitjen e prodhimit;
 7. të detajohet eksperiencia e kërkuarit të lejes në shfrytëzimin e karrierave dhe tregtimin e mineraleve dhe materialeve të tipeve që do të prodhohen nga kariera;
 8. të jepen hollësi në aspektet e ruajtjes së ambientit në lidhje me operacionet e propozuara të punës në karrierë, duke përfshirë këtu:
 - (i)- propozime për ndalimin e ndotjes, trajtimin e sterileve dhe ruajtjen e burimeve natyrore;
 - (ii)- efektet rajonale të parashikuara për ndotjen e ambientit nga puna në karrierë dhe propozimet për minimizimin e tyre;
 - (iii)- rreziqet e veçanta (për shëndetin ose ndonjë diçka tjetër), të cilat mund të ndodhin gjatë shfrytëzimit të mineraleve dhe materialeve, si dhe propozimet për kontrollin dhe eliminimin e tyre;
 9. të jepen detaje të propozimeve të kërkuarit në lidhje me punësimin dhe specializimin e shtetasve shqiptarë.

Neni 71

Ministri duhet të njoftojë për vendimin e tij mbi kërkesën për një leje kariere brenda 30 ditësh pas marrjes së saj. Forma e lejes është e përcaktuar sipas rregulloreve. Leja mund të përmbajë edhe kushte të tjera specifike të cilat përcaktohen në të.

Neni 72

Në lidhje me lejen e tipit të dytë të lejes së karierave në të cilën prodhimi është parashikuar për eksport, Ministri negocion dhe hyn në marrëveshje me kërkuesin e lejes së karierës, për një marrëveshje lehtësuese të tipit të dhënë sipas nenit 44.

Neni 73

(Zëvendësuar shprehje me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Zotëruesi i lejes së karierës duhet t'i paguajë shtetit në datën efektive të dhënies së lejes së shfrytëzimit dhe në çdo vit në të njëjtën datë, një pagesë vjetore 150 000 lekë për km² të zonës së tij të lejuar për shfrytëzim.

Neni 74

Zotëruesi i lejes së karierës, jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo muaji kalendarik, duhet t'i paguajë shtetit ekuivalentin në lekë të frangave zvicarane, një rentë pasurie minerare (royalty) prej 2% të vlerës së tregut për sasinë e përgjithshme të mineralit të shitur tek konsumatorët gjatë këtij muaji kalendarik dhe të prodhuar nga zona e tij e lejuar.

Procedura e përcaktimit të vlerës së tregut të mineraleve përcaktohet me rregullore.

Neni 74/1

(Shtuar me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Paragrafët dy dhe tre të nenit 47, nenet 53, 54, 55, 56, 57, 58, 60, 61 dhe 62 zbatohen edhe për mineralet e grupit të katërt, ndërsa neni 59 zbatohet për një afat së paku prej 30 ditësh.

Neni 75

(Hequr fjalë me ligjin nr. 8093, datë 21.3.1996)

Ministri ka të drejtë që me një akt të veçantë t'ju japë për administrim organeve të pushtetit lokal materialet e ndërtimit të grupit të katërt (dheun mbushës).

KAPITULLI IX GRUPI I 5 DHE I 6 I MINERALEVE

Neni 76

Asnjë person nuk mund të kërkojë ose të shfrytëzojë mineralet e grupit të 5 ose të 6 pa një leje minerare të nxjerrë nga Ministri.

Neni 77

Përpara se të kërkojë një leje minerare, kërkuesi duhet të konturojë zonën e sipërfaqes së tokës për të cilin ai dëshiron të marrë lejen minerare dhe duhet të njoftojë nëpërmjet organeve të pushtetit lokal pronarin ose pronarët e një toke të tillë nëse kjo nuk është e shtetit, për arsyen sepse ai kërkon ta shfrytëzojë këtë pasuri respektive të tyre për të kërkuar një leje minerare.

Neni 78

Çdo person, përfshirë edhe një person i cili ka një leje minerare për grupet e tjerë të mineraleve në disa pjesë ose në të gjithë zonën, mund të kërkojë tek Ministri një leje minerare që mbulon mineralet e grupit të 5 ose të 6. Kërkesa duhet:

- a. të përmbajë emrin dhe adresën e kërkuarit;
- b. të përcaktojë tokën me të cilën lidhet kërkesa e kërkuarit të lejes dhe të specifikojë nëse kjo tokë zotërohet nga shteti ose pronarë të tjerë;
- c. të japë emrin dhe adresën e çdo pronari të regjistruar të tokës me të cilën lidhet kërkesa për leje minerare në rast se kjo tokë nuk është pronë e shtetit. Të sigurojë pëlqimin me shkrim të pronarit të regjistruar të tokës për dhënien e lejes minerare mbi pasurinë e tij;
- ç. të specifikojë mineralet dhe materialet e grupit të 5 dhe të 6 për të cilët kërkohet leja minerare.

Neni 79

Brenda tridhjetë ditësh pas marrjes së kërkesës, Ministri duhet të njoftojë kërkuarin e lejes minerare për vendimin e tij në lidhje me kërkesën. Në qoftë se Ministri vendos që të japë lejen minerare, ai duhet të përfshijë në njoftim vlerën e rentës së pasurisë minerare (royalty), kushtet e veçanta, nëse ka, të cilat duhet të zbatohen nga zotëruesi i lejes minerare, si dhe marrëveshjen dhe garancitë e tjera që kërkuari i lejes (në bashkërendim me Ministrin) duhet të zbatojë me qëllim që të garantojë:

- (i) - raportimin korekt të të gjitha mineraleve të shfrytëzuara nga zona e tij minerare e lejuar
- (ii) - vlerën e këtyre mineraleve
- (iii) - pagimin në vlerën dhe kohën e caktuar të rentës së pasurisë minerare (royalty), që përfshin leja e tij minerare.

Neni 80

Një leje minerare mund të jepet për një zonë maksimale 2 ha dhe të jetë një e tërë. I njëjti person mund të mbajë më shumë se një leje të tillë njëkohësisht. Një leje minerare nuk mund të jepet për një zonë për të cilën është dhënë më parë një leje tjetër minerare në përputhje me këtë ligj me përjashtim të rastit kur zotëruesi i kësaj leje minerare të dhënë jep më parë pëlqimin e tij të pakthyeshëm me shkrim.

Neni 81

Një leje minerare vlen për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh duke filluar nga data kur Ministri njofton për pranimin e kësaj kërkesë për lejen minerare.

Neni 82

Zotëruesi i lejes minerare, në përputhje me kushtet e vëna nga Ministri në lejen e tij mund të kërkojë, zbulojë dhe shfrytëzojë mineralet dhe materialet e grupit 5 dhe 6 për të cilët i është dhënë leja. Gjithashtu në lidhje me kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin e këtyre mineraleve dhe materialeve kërkuari mund:

- a. të ngrejë ndërtesa dhe objekte që i shërbejnë punës për të cilën i është dhënë leja;
- b. të ushtrojë çdo të drejtë në përputhje me lejen që i është dhënë;
- c. të kryejë brenda zonës së tij të lejuar çdo aktivitet për kërkim, zbulim dhe shfrytëzim

të mineraleve dhe materialeve për të cilët i është dhënë leja;

ç. të nxjerrë prej zonës së tij të lejuar të gjitha mineralet dhe materialet për të cilët i është dhënë leja;

d. të shesë mineralet dhe materialet e nxjerra vetëm nëpërmjet një personi me licencë për tregtim mineralash dhe në asnjë mënyrë tjetër.

Neni 83

Zotëruesi i lejes minerare brenda pesë ditësh pas mbarimit të çdo muaji kalendarik duhet t'i paguajë shtetit rentën e pasurisë minerare në përqindje të vlerës së tregut për të gjitha mineralet e nxjerra dhe të shitur nga zona e tij gjatë gjithë muajit. Madhësia e rentës mujore së pasurisë minerare (royalty) është 2% e vlerës së tregut për sasinë e përgjithshme të mineralit të shitur tek konsumatorët gjatë çdo muaji kalendarik dhe të prodhuar nga zona e tij e lejuar.

Neni 84

Zotëruesi i lejes minerare në lidhje me regjistrimin dhe shitjen e mineraleve dhe materialeve të nxjerrë nga zona e tij e lejuar duhet të përmbushë të gjitha rregullat dhe procedurat që përcaktohen në rregullore.

Neni 85

Asnjë person nuk mund të tregtojë me grupin e 5 ose të 6 të mineraleve nëse nuk ka një licencë të nxjerrë nga Ministri për tregtimin e mineraleve.

Neni 86

Kërkesa për licencën e tregtimit të mineraleve duhet:

- a. të përmbajë emrin dhe adresën e kërkuarit;
- b. të detajojë eksperiencën e kërkuarit në tregtimin e mineraleve të grupit të 5 dhe të 6;
- c. të specifikojë mineralet për të cilët kërkohet licenca e tregtimit të tyre;
- ç. të paraqesë të dhëna mbi burimet financiare të vlefshme për kërkuarin e licencës për tregtimin e mineraleve të propozuara.

Neni 87

Ministri në përputhje me nenin 86 duhet të njoftojë kërkuarin e licencës brenda tridhjetë ditësh pas marrjes së kërkesës.

KAPITULLI X

MARRËDHËNIET NDËRMJET ZOTËRUESVE TË LEJEVE MINERARE DHE PRONARËVE TË SIPËRFAQES SË TOKËS

Neni 88

Marrëdhëniet ndërmjet zotëruesve të lejeve minerare dhe pronarëve të sipërfaqes së tokës rregullohen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

KAPITULLI XI

DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË ZOTËRUESIT TË LEJES MINERARE

Neni 89

Çdo zotërues i një leje minerare në lidhje me zgjedhjen e punonjësve të cilët kërkojnë punë dhe zotërojnë eksperiencën e duhur për të gjitha nivelet e punës, duhet të ketë preferencë për shtetasit shqiptarë.

Neni 90

Çdo zotërues i lejes minerare duhet të ndërmarrë specializimin e personelit të tij shqiptar.

Neni 91

Zotëruesi i një leje minerare merr masat e nevojshme dhe përgjigjet për të siguruar jetën, kushtet e punës dhe shëndetin e punonjësve të tij dhe të gjithë personave të tjerë, të cilët hyjnë në zonën ku zotëruesi i lejes minerare kryen operacionet e tij të punës në përputhje me rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

Neni 92

Zotëruesi i lejes minerare duhet të sigurojë pajisje mjekësore bazë dhe ekipin mjekësor përkatës.

Neni 93

Zotëruesi i lejes minerare zbaton gjatë të gjithë kohës së aktivitetit të tij minerar sigurimet shoqërore sipas ligjit përkatës shqiptar.

Çdo sigurim që zotëron zotëruesi i lejes minerare ose ortakët e tij kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar të sigurimeve.

Neni 94

Zotëruesi i lejes minerare duhet të mundësojë inspektimin e operacioneve të tij të punës nga përfaqësuesit e autorizuar të shtetit.

Neni 95

Zotëruesi i lejes minerare, duhet të garantojë që të gjitha aktivitetet që lidhen me lejen e tij minerare janë kryer në përputhje me rregullat për mbrojtjen e ambientit. Zotëruesi i lejes minerare, në rastet kur konstatohet se ndonjë instalim ose operacion i kryer nga ky zotërues ose në emër të tij dëmton pasurinë e të tjerëve ose shkakton ndotjen e florës dhe faunës së ekosistemit, duhet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 96

Zotëruesi i lejes minerare duhet të përgatisë një plan operativ pune për ruajtjen e mjedisit, i cili duhet të jetë i miratuar nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

Plani përveç të tjerave përfshin transportin dhe depozitimin e sterileve në gjendje të ngurtë, të lëngët ose të gaztë, që rrjedhin nga operacionet e tij të punës.

Neni 97

Zotëruesi i lejes minerare, i cili përdor ujë në operacionet e tij të punës, duhet ta kthejë atë në lumë, liqen ose burime të tjera prej të cilave e ka marrë në gjendje të pastër, në mënyrë që të mos ndikojë në shëndetin e njerëzve dhe në zhvillimin e florës dhe të faunës.

Neni 98

Reabilitimi i sipërfaqes së tokës që lidhet me aktivitetin minerar duhet të realizohet nga zotëruesi i lejes minerare në përputhje me një program të veçantë reabilitimi të propozuar nga zotëruesi i lejes dhe të miratuar nga Ministri.

Neni 99

(Shtuar shkronja “c” me ligjin nr. 9667, datë 29.12.2006)

Në rastet kur leja minerare ka përfunduar ose zona që i përket lejes minerare është braktisur, personi i cili ishte zotëruesi i lejes minerare menjëherë para përfundimit ose braktisjes së lejes apo të zonës minerare, duhet të rehabilitojë këtë sipërfaqe dhe ta sjellë atë në gjendjen e saj natyrore të mëparshme brenda një periudhe kohe të arsyeshme. Ky veprim quhet i kryer kur është miratuar prej Ministrit. Një veprim i tillë nuk zbatohet për rastin e objekteve ose ndërtesave:

a. të cilat shteti mund t’i pranojë (me njoftimin e Ministrit) si prona të veta pa të drejtë shpërblimi;

b. të cilat pronari i tokës dëshiron të mbeten të tij dhe për të cilat ëshët rënë dakord ndërmjet tij dhe zotëruesit të mëparshëm të lejes minerare me shkrim në një marrëveshje të noterizuar.

c. zonat minerare, veprimtaria minerare e të cilave vlerësohet e përfunduar apo e braktisur, kalojnë në procesin e monitorimit postminerar. Mënyra dhe kriteret për realizimin e këtij procesi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KAPITULLI XII

PËRFITIMET SPECIFIKE PËR TË NXITUR INVESTIMET PRIVATE

Neni 100

Kur Ministri e gjykon se aktiviteti i zotëruesit të lejes minerare dhe ortakëve të tij është orientuar kryesisht për eksport dhe me qëllim që të nxiten investimet në sektorin minerar, zotëruesit të lejes minerare dhe ortakëve të tij në përputhje me nenin 44, u garantohen përfitime shtesë për mineralet e grupit të 1,2 ose të 3, të cilat renditen më poshtë:

a. E drejta të importojë direkt mjetet dhe pajisjet e kërkuara për operacionet e punës;

b. e drejta të mbajë llogaritë në USD ose në monedhë të huaj tjetër të pranueshme nga Baka e Shqipërisë;

c. e drejta të shkëmbejë monedhën e huaj në monedhë lokale sipas kursit të Bankës së Shqipërisë në kohën e këtij shkëmbimi;

d. e drejta që të marrë dhe depozitojë jashtë shtetit fitimet e tij të siguruara nga shitjet në eksport duke mbuluar shpenzimet e kryera;

e. e drejta të konvertojë të ardhurat në valutë vendase në të huaj sipas kursit të Bankës

së Shqipërisë që kërkohen për pagimin e importeve, për borxhet me jashtë, fitimin dhe pjesët që do ndajë me ortakët;

f. e drejta të hapë llogari të huaj në lidhje me projekte financimi;

g. e drejta të mbajë dhe të verë në punë llogari bankare në Shqipëri dhe jashtë shtetit;

h. të sigurohet që sektori minerar në lidhje me sektorët e tjerë të ekonomisë të mos jetë më pak i favorizuar kundrejt paketës fiskale, e cila konsiston në:

(i) tatimi mbi pronën dhe tokën siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar;

(ii) taksat doganore të importit, sipas raporteve që përcaktohen në legjislacionin shqiptar;

(iii) renta e pasurisë minerare (royalty) siç përcaktohet në këtë ligj;

(iv) taksa mbi fitimin në madhësi siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar dhe në datat efektive të dhënies së lejes minerare;

(v) taksat lokale të juridiksionit ku vepron firma sipas legjislacionit në fuqi;

i. përjashtimi sipas legjislacionit në fuqi për tatim qarkullimi ose për tatimet e tjera që do të zëvendësojnë atë për subjektet që përfitojnë nga ky ligj;

j. garancia e stabilitetit të paketës fiskale gjatë gjithë periudhës së zotërimit të lejes minerare për subjektet që e përfitojnë atë sipas këtij ligji;

k. garancia që legjislacioni në përputhje me të cilin është dhënë e drejta minerare të zbatohet ndaj zotëruesit të së drejtës minerare dhe ortakëve të tij gjatë gjithë kohës së zotërimit të lejes minerare për ato subjekte që e kanë përfituar atë në përputhje me këtë ligj. Ndryshimet në këtë legjislacion, përfshirë këtu dhe hyrjen në fuqi të ligjeve të reja, nuk do të jenë të zbatueshme për këto subjekte me përjashtim vetëm të rastit kur Ministri dhe zotëruesi i lejes minerare bien dakord me shkrim;

l. e drejta që çdo mosmarrëveshje midis shtetit dhe zotëruesit të lejes minerare të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me rregullat e caktuara të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit (International Chamber of Commerce, Paris France) ose të një gjykate kompetente shqiptare.

Neni 101

Në rastet kur Ministri zgjeron disa ose të gjitha përfitimet sipas nenit 100 për zotëruesin e të drejtës minerare, këto përfitime duhet të specifikohen në dokumentin e lejes minerare ose të marrëveshjes lehtësuese.

KAPITULLI XIII REGJISTRI I LEJEVE MINERARE

Neni 102

(Zëvendësuar shprehje me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Drejtoria e Përgjithshme e Minierave mban një regjistër të të gjitha lejeve minerare të dhëna, të rinovuara, të transferuara ose të anuluar. Për çdo regjistrim bëhet një pagesë 30 000 lekë. Regjistri duhet të mbahet i gatshëm për inspektim.

Neni 103

Në lidhje me çdo veprim ligjor që ka të bëjë me lejen minerare të regjistruar:

a. ka përparësi leja e regjistruar ndaj asaj të paregjistruar;

b. ka përparësi leja e regjistruar më parë ndaj asaj të regjistruar më vonë.

Neni 104

Asnjë transferim i lejes minerare dhe të drejtave të saj nuk do të jetë i efektshëm po qe se nuk miratohet me shkrim nga Ministri dhe po qe se transferimi dhe aprovimi i Ministrit nuk janë të regjistruara në regjistër.

KAPITULLI XIV

MASAT NDËSHKUESE QË MERREN NË RASTET KUR KRYHEN AKTIVITETE MINERARE PA LEJE TË VLEFSHME MINERARE; E DREJTA E MINISTRIT PËR TË HEQUR TË DREJTËN MINERARE

Neni 105

(Zëvendësuar shprehje me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Një person i cili kryen aktivitete minerare pa një leje minerare të nxjerrë në përputhje me këtë ligj konsiderohet shkelës i këtij ligji dhe është i detyruar në këtë rast të paguajë një gjobë të përcaktuar nga Ministri, e cila duhet të jetë jo më pak se 500 000 lekë dhe jo më shumë se 5 000 000 lekë për çdo shkelje.

Neni 106

(Ndryshuar me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

1. Shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe Drejtoria e Përgjithshme e Minierave ka të drejtë të vendosë gjobat, si më poshtë:

a) kur, pas dhënies së lejes, vërehet se në kërkesën për leje minerare ka të dhëna dokumentare-financiare të pasakta, gjoba është 100 000 lekë;

b) kur kryhen shkelje të detyrimeve, që janë përcaktuar në lejen minerare, gjoba është 50000 lekë;

c) kur në mënyrë të pajustificueshme, ulet prodhimi në një zonë minerare të lejuar, gjoba është nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë;

ç) kur kryhen shkelje të tjera të ligjit minerar, gjoba është nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

2. Në rast përsëritjeje të shkeljeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” dhe kur shoqëria mbyll ose ndalon punën në një minierë për njëqind e tetëdhjetë ditë rresht, subjektit i hiqet leja minerare.

Kundërvajtësit kanë të drejtë të ankohen te ministri përkatës brenda 1 muaji nga data e vënies së gjobës.

Neni 106/1

(Shtuar me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Kundër vendimit të ministrit subjekti ka të drejtën e ankimit, sipas ligjit “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 107

Heqja e lejes minerare në përputhje me nenin 106 duhet të ndjekë procedurën e mëposhtme:

a. Ministri duhet të njoftojë zotëruesin e lejes minerare duke specifikuar qëllimin e tij për të hequr lejen minerare dhe arsyen e një veprimi të tillë.

b. Zotëruesit të lejes minerare i jepen nëntëdhjetë ditë afat pas marrjes së njoftimit të mësipërm për:

(i)- të apeluar në gjykatë mbi mosmarrëveshjet ndërmjet shtetit dhe zotëruesit për një leje minerare të dhënë (në arbitrazhin ndërkombëtar ose gjykatat shqiptare), në qoftë se ai mendon se vendimi i Ministrit për heqjen e lejes minerare nuk është i drejtë.

(ii)- të rregullojë me pëlqimin e Ministrit shkeljet që përmbahen në nenin 106/b, c, e, për të cilat kërkohet t'i hiqet leja minerare;

c. Në qoftë se zotëruesi i lejes minerare apelon në lidhje me pikën b,(i)-, të këtij neni për vlefshmërinë e vendimit të heqjes së lejes minerare, Ministri nuk mund të vazhdojë procedurën për heqjen e lejes pa vendimin përfundimtar të gjykatës, me kusht që zotëruesi i lejes minerare të veprojë konform me procedurën për apelim.

d. Në se zotëruesi i lejes minerare nuk zbaton të drejtat e pikës b të këtij neni, atëherë atij pas nëntëdhjetë ditësh nga data e njoftimit të Ministrit, në përputhje me pikën a të këtij neni, i hiqet e drejta e zotërimit të lejes minerare.

Neni 108

Kur hiqet leja minerare për një arsye të specifikuar në nenin 106, Ministri ka të drejtë të ekzekutojë çdo pikë të marrëveshjeve të kryera nga ky zotërues ose në emër të tij dhe të ndjekë pa kufizim çdo të drejtë tjetër ligjore, që ai mund të ketë për të marrë kompensimin nga dëmet e shkaktuara nga ky person.

KAPITULLI XV TË NDRYSHME

Neni 109

Të gjitha njoftimet e kërkuara ose të lejuara në përputhje me këtë ligj duhet të jenë me shkrim.

Neni 110

Të dhënat teknike dhe provat studimore që zotëruesi i lejes minerare i dorëzon në Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave duhet të mbahen sekret nga shteti, me përjashtim të rasteve kur zotëruesi i këtyre të dhënave është dakord që të ndiqet radha e mëposhtme (nuk mund të kryhet ekzekutimi i pikës pasardhëse para asaj paraardhëse):

a. Përfundimi i afatit të së drejtës minerare.

b. Lënia e zonës në të cilën janë marrë të dhënat teknike dhe provat studimore.

c. Dy vjet pas nga data e marrjes së këtyre të dhënave dhe pronave prej Drejtorisë së Minierave.

d. Publikimi i të dhënave të tilla.

Ky nen nuk mund të kufizojë të drejtën e shtetit për të përdorur një informacion të tillë për përgatitjen e raporteve ekonomiko-financiare që i nevojiten atij.

Neni 111

Zotëruesi i lejes minerare për grupet 1, 2 dhe 3 të mineraleve ka të drejtë të importojë minerale në Shqipëri për përpunim dhe pastaj t'i rieksportojë ato duke u përjashtuar nga taksat për importin, eksportin dhe taksat e tjera shtetërore.

Neni 112

Shteti ose çdo person që vepron në emër të tij në asnjë rast nuk është i detyruar ndaj të tretëve të paguajë dëmtimet e personave ose të pasurisë që rrjedhin si rezultat i ushtrimit të së drejtave minerare të bazuara në këtë ligj. Zotëruesi i lejes minerare duhet të sigurojë shtetin dhe të mos dëmtojë shtetin ose ndonjë person që vepron në emër të tij për veprimet e kryera nga palët e treta.

Neni 113

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.783, datë 28.2.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**

TABELA A GRUPET E MINERALEVE

GRUPI I PARË (1) MINERALET METALIKE

Antimoni	Molibdeni
Argjendi	Monaziti
Ari	Nikeli
Arseniku	Oksidi i hekurit
Bakri	Osmiumi
Bismut	Piritet e arsenikut
Çesium	Platini
Çinabar	Plumbi
Feldshpati	Rubidium
Galena	Rutili
Garneti	Seleni
Germaniumi	Squfuri
Hekur	Sheelit
Ilmeniti	Tantali
Indium	Titani
Kallaji	Toriumi
Kandmium	Tungsteni dhe mineralet e tij
Kobalti	Vanadiumi
Kromiti	Volframi
Kolumbium	Vulfeniti
Litiumi	Zinku
Mangani	Zirkoni
Mineralet e hekurit	Zhiva
Mineralet e platinit	
Mineralet e tokave të rralla	

GRUPI I DYTË (2) MINERALET JOMETALIKE

Alumina	Krioliti
Aluniti	Kripa e gurit
Apatiti	Kuarciti
Asbest	Lateriti
Baritet	Magnezitet
Boksitet	Mika
Berili dhe mineralet e tij	Mineralet e silicit
Boratet	Perliti
Ceoliti	Pigmentet e
mineraleve	
Dhe diatomik	Pirofilit
Feldshpati	Rifet kuarcore
Fosfatet	Stralli
Grafiti	Steatiti
Grafiti argjilor	Smeraldi
Gurët abraziv	Shpati i Islandës
Gurë sapuni	Talku
Haliti	Torfat
Hi shistoz	Topazi
Kalciti	Vermikuliti
Kloriti	Volastoniti

GRUPI I TRETË (3) QYMYRET DHE BITUMET

Qymyret	Reshpet naftore
Bitumet	Pirobitumet
Rërat bituminoze	

GRUPI I KATËRT (4) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 9261, datë 22.7.2004)

Agregatet detare	Gipsi
Anhidritet	Gabrot
Argjilabentonite	Kaolina
Argjilat për tulla	Mermeri
Argjilat për tubacione	Ofikalcitet
Argjilat për porcelan	Pllakat e ndërtimit
Argjilat zjarrduruese	Pllagjiogranitet
Argjilat dhe shistet	Ranoret
argjilore (për ndërtim)	Serpentina

Bentonite
Çakëlli (brekcet e shpatit)
Dolomiti
Dhe mbushës
Graniti
Gëlqerorët
Bazaltet

Sieniti
Shiste argjilore
Travertinat
Tufet
Konglomeratet
Traktolitet

GRUPI I PESTË (5) GURËT E ÇMUAR

Diamanti
Korundi

Rubini
Safiri

GRUPI I GJASHTË (6) GURËT GJYSËM TË ÇMUAR DHE OPALI

Agati
Kalcedoni
Kristalet e kuarcit
Nefriti
Opali

Rodoniti
Torkuazi
Turmalina